



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi komunal  
O1 Nr.06-20-10130/1  
Dt.25.06.2014  
D r a g a s h

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe të nenit 32.2 të Statutit të komunës- Dragash, në seancën e Kuvendit Komunal të Dragashit të dt.25.04.2014, pas shqyrtimit paraprak, miratohet ky:

## V E N D I M

I.MIRATOHET Plani Komunal për Eficiencën e Energjisë/2014-2020 i mështetur me kontribut në hartimin e tij nga BE-ja - Zyra në Prishtinë në bashkëpunim me UNDP-ë dhe komunën e Dragashit.

II. Për implementimin e këtij Plani OBLIGOHEN drejtoratet e komunës-Dragash.

III. Për veprimet ndërmarra të njoftohet Kuvendi Komunal dhe kryetari i komunës-Dragash.

IV. Ky Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit.



### *A r s y e t i m*

Plani është hartuar në bazë të angazhimeve të subjekteve të sipërpërmendura në pikën I të këtij Vendimi dhe si i këtillë do të shërben si dokument i mëtejshëm zhvillimor në lëmin e eficiencës së energjisë në territorin e komunës së Dragashit nga subjektet dhe individët, si dhe nga donatorët e mundshëm për periudhën e cekur 6-vjeçare / 2014-2020.

I dërgohet:

- UNDP-së,përfaqësisë në Dragash,
- Drejtorateve të komunës-Dragash,
- Kryetarit të Komunës-Dragash z.Salim Jenuzi, dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL- DRAGASH  
Kryesuesi  
*Shaban Shabani*





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
**Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality**

**-Kuvendi Komunal**  
**01 Nr.020-10130/2**  
**Dt.25.06.2014**  
**D r a g a s h**

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 32.2 të Statutit të Komunës-Dragash e konform shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (VI Nr.0204-712/4 të dt.28.05.2014) dhe të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Nr.1359 të dt.16.05.2014 (referenca 05/49/2014 dt.15.05.2014) lidhur me rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit Komunal të Dragashit 01 Nr.06-6541/2 të dt.29.04.2014 për Themelimin e Vendgjuetisë së Hapur Komunale të Dragashit, Kuvendi Komunal i Dragashit, pas shqyrtimit paraprak, në seancën e dt.25.06.2014, miraton këtë:

## V E N D I M

**I. ANULOHET** Vendimi 01 Nr.06-6541/2 i dt.29.04.2014 lidhur me themelimin e vendgjuetisë së hapur komunale të Dragashit i cili nga ministrinë e larpërmendura konsiderohet në kundërshtim me nenin 19.2 të Ligjit Nr.L-53 për Gjuejinë dhe nenin 8 pikat 1,2,3,4,5 dhe 6 të UA Nr.10/2007 për Kriteret e Caktimit të Zonave për Themelimin e Vendgjuetive, si dhe neneve 27 e 34.2 të Ligjit në fjalë dhe UA Nr.06/2009, ku për menaxhimin e vendgjuetive kërkohet PËLQIMI paraprak i Ministrisë.

**II.AUTORIZOHET** Drejtorati i Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe Inspekcioni i Komunës-Dragash që lidhur me këtë çështje të ndërmarrin masat e nevojshme ligjore të parapara me Ligjin për Gjuejinë dhe udhëzimet e cekura administrative në pikën I të këtij Vendimi.

**III.Për hapat e ndërmarr të njoftohet kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal-Dragash.**

### *Arsyetim*

Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.29.04.2014, duke shqyrtuar Propozimin për Themelimin e Vendgjuetisë së Hapur Komunale të Dragashit miraton Vendimin 01 Nr.06-6541/2 me bindje se Pëlqimi nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të sigurohet, pas miratimit të Vendimit në fjalë për themelimin, e që nga 2 ministrinë e lartëcekura është konsideruar si veprim antiligjor.

Andaj, duke pasur parasysh faktet e lartëcekura, Kuvendi Komunal i Dragashit, pas rishqyrtimit paraprak, në seancën e dt.25.06.2014, vendosi si në pikat I, II dhe III të këtij Vendimi.

Shtojcë: Vendimi kontestues i KK-së Dragash 01 Nr.06-6541/2 i dt.29.04.2014, shkresat e MAPL-it dhe MBPZHR-së...për rishqyrtim të Vendimit lidhur me ligjshmërinë.

I dërgohet:

- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore)-Prishtinë,
- Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (Departamenti të Pylltarisë)-Prishtinë,
- Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Inspekcioni Dragash,
- Kryetarit të Komunës-Dragash, dhe
- Arkivit



Kryesuesi i KK-së Dragash  
*Shaban Shabani*





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
**Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality**

- Kuvendi Komunal  
01 Nr.020-10130/3  
Dt.25.06.2014  
D r a g a s h

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqverisje Lokale dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit, duke u bazuar në nenet 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi Komunal i Dragashit, pas shqyrtimit paraprak, në seancën e dt.25.06.2014, miraton këtë:

## V E N D I M

**I.THEMELOHET** Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në këtë përbërje:

1. Salim Jenuzi, kryetari komunës-Dragash, (kryesues i Këshillit),
2. Gëzim Zogaj, kom. i Stacionit të Policës së Kosovës në komunën e Dragashit, anëtar,
3. Xhafer Fejziu, përfaqësues i KBIslame-Dragash, anëtar,
4. Bajreta Selimi, përfaqësues i komunitetit shqiptar nga f.Xerrxe, anëtare,
5. Xhenisa Hamza, përfaqësuese e komunitetit boshnjak nga f.Krstec,anëtare,
6. Sejdefa Isaković,përfaqësuese e komunitetit goranë, nga Dragashi, anëtare,
7. Lindita Piraj, zyrtare për barazi gjinore-Dragash, anëtare,
8. Velid Haxhisin, kryesues i Komitetit për Komunitete të KK-së Drgash, anëtar,
9. Hajri Ramadani, drejtor i DKArsimit, anëtar,
10. Feti Jusufi, kryetar i Këshillit të Prindërëve të Arsimit-Dragash, anëtar,
11. \_\_\_\_\_përfaqësues nga FSK-ja, anëtar,
12. Behar Brenolli,përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi, anëtar,
13. Fahri Piraj, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, anëtar,
14. Tafil Krasniqi,përfaqësues i Sektorit të Emergjencave Civile të Komunës-Dragash, anëtar,
15. Mehmet Hamza, përfaqësues i ZKKëthimit-Dragash, anëtar, dhe
16. Suad Tosuni, përfaqësues i OJQ-ve("Renesansa"), kom.biznesit, mediave, p.a. kufizuara, anëtar,

II. Anëtarët e këtij Këshilli kanë mandat të njejtë sikurse delegatët e KK-së dhe konform nenit 18 të Udhëzimit të larpërmendur Administrativ (përfshi edhe zyrtarin e komunal të këtij Këshilli-Azbi Halili), për punën e tyre nga buxheti i Komunës-Dragash paguhen vetëm për 6 takime të Këshillit brenda vitit kalendarik, në shumë ekuivalente të anëtarëve të KPFinanca.

III. Për implementimin e këtij Vendimi përkujdeset kryetari i komunës-Dragash dhe DEFinanca i komunës-Dragash.

IV. Vendimi hynë në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin Komunal të Dragashit.

Kryesuesi i KK-së  
**Shaban Shabani**

